

Dt. 19.06.2018

Tiranë , 18 Qershori 2018

Prot. Nr. 121



Drejtuar:

Zotit Ilir Butka
Kryetar i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë,

Për dijeni:

Zotit Engjëll Agaci
Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave

Zonjës Mirela Kumbaro Furxhi
Ministër i Kulturës

Zonjës Lindita Nikolla
Ministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë

Objekti:

Përgjigje shkresës së QKK-së me Nr. 282 dt. 6.06.2018, mbi Projekt Marrëveshjen e Bashkëpunimi QKK-AFMM.

Zoti kryetar i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë,

Më dt. 11 Qershori 2018, pas propozimit tonë për një Akt-Marrëveshje bashkëpunimi QKK-AFMM morrëm një përgjigje ku përveç mungesë së vullnetit, në të ka insinuata dhe moskuptueshmëri të Akt- Marrëveshes.

Në përgjigje, bëhet një amalgamë, lidhur me fjalën Memorandum, kur në fakt AFMM askund nuk e përmëndim fjalën Memorandum. Në një Akt-Marrëveshje është e qartë se parashikohen të drejta dhe detyrime të palëve nënshkruese.

AFMM nuk ka kërkuar dhe nuk kërkon asnjë lloj favori ekstra ligjor apo shpikje, përveç zbatimit literal të Ligjit të Kinematografisë.

Ju thoni, se Akt Marrëveshja është njëloj si ajo e propozuar më parë në projekt VKM e Këshillit të Ministrave për dhënien e Statusit të Veçantë AFM Marubit. Nuk kuptojmë përveç dashakeqësisë, ku qëndron problemi që shkollës sonë të filmit pas 15 vjetësh aktivitet, Shteti Shqiptar i dha sipas ligjit, Statusin e Veçantë?!

Do ju lutesha të ndalonit insinuatat duke përzjerë gjérat me mendimin se opinioni juaj ka patur ndikim në VKM-në e Statusit të Veçantë të Marubit ashtu sikurse bëtë dhe në Black Box të UA-së, kur përzjetë projekt-ligjin për Artin dhe Kulturën me projekt VKM e Statusit të Veçantë të Akademisë Marubi.

Thoni se, AFMM kërkon të financohet nga QKK pa aplikuar si çdo subjekt tjetër. Sigurisht sepse AFMM nuk është si çdo subjekt tjetër. Ajo ka atributin ligjor të arsimit të lartë që u jepet institusioneve që veprojnë në fusha me interes kombëtar si Mbrojtja, Siguria publike, Mjekësia dhe Arti. Eshtë pikërisht nisur nga ky fakt, AFMM kërkon të nënshkruej një Akt-Marrëveshje me QKK, sepse aktiviteti i saj mbështet në ligjin e Arsimit të Lartë për programin akademik dhe në Ligjin e Kinematografisë për produksionin kinematografik.

Ju thoni pse shprehemi në përqidje? Mbështetjen financiare AFMM e kërkon në përqindje nga QKK, sepse në asnjë marrëveshje nuk mund të shprehen shifra egzakte, por struktura me përqindje të cilat, përkthehen në shifra. Në Akt- Marrëveshje QKK bëhet pjesë e Këshillit të

AKADEMIA E FILMIT DHE MULTIMEDIAS MARUBI

Kinostudio - Rr. Aleksandër Moisiu nr.78 - Tiranë 1000, Shqipëria
Tel./Fax : +355 42 365 188/157. - info@afmm.edu.al www.afmm.edu.al



AFMM-së dhe si e tillë asaj i lind e drejta të kontrollojë transparencën e financimit të saj, në përputhje me numrin e studentëve nga ku përcaktohet përqindja e çdo viti akademik.

Me lejoni t'ju them se, çdo keqinterpretim apo insinuatë për çështje që prekin interesa strategjike kulturore, nuk i shërben askujt.

Një tjetër insinuatë, është cilësimi i AFMM-së si person juridik publik. Unë nuk di ku, e nga e keni nxjerrë këtë term?! Në VKM e Statusit të Veçantë përcaktohet qartë statusi juridik i AFMM-së.

Keni gjithashtu, një keqinterpretim të nenin 30 (i) të Akt-Marrëveshjes, sqaroj se siç e përmendim më lart, AFMM nuk është si shtëpitë e tjera kinematografike, sepse AFMM për aktivitetin që kryen, ka Statusin nominativ të Veçantë për edukim kinematografik dhe po kështu si shtëpi kinematografike, ajo është licensuar rregullisht që prej vitit 1996, nga QKK.

Njëherësh, Akt-Marrëveshja nuk është projekt artistik që mund të miratohet nga Këshilli i Miratimit të Projekteve, por një akt politik që lidhet me mbështetjen strategjike afatgjatë të zhvillimit të kinematografisë siç përcaktohet qartë në ligjin të kinematografisë. Pikërisht për këtë arsy, Akt-Marrëveshja firmoset nga kryetari i QKK, i cili ngarkohet nga shteti për ushtrimin e ligjit dhe të politikave të zhvillimit të kinematografisë.

Sygerimi, për të aplikuar për finacim filmash të studentëve është i gabuar. Ky lloj financimi, godet strukturën pedagogjike, dhe në thelb është akt sporadic e deskriminues për studentët të cilët ende nuk jan autorë. Një sygjerim i tillë justifikon shkeljet ligjore të bëra nga QKK më parë, për finacime të kësaj natyre tek procesi akademik dhe nuk jep kurfar garancie bashkëpunimi afatgjatë institucional.

Lidhur me mbulesën e bursës dhe workshopeve, ato janë pjesë e programeve tona akademike dhe nuk mund të janë selektive dhe të shkëputura nga programi akademik.

Së fundmi ju lutem më thoni, në çfarë kuadri ligjor dhe ekspertize, drejtues të QKK-së vendosin praktikën administrative, sipas së cilës Këshilli i Miratimit të Projekteve miraton; projekte që nuk kanë lidhje me projekte artistike apo produksioni filmik?

Mendoj se për çështje financiare sipas ligjit QKK ka Komisionin Financiar dhe jo Këshillin e Miratimit të Projekteve. Nuk di se ku, bazoheni ju që Këshilli i Miratimit të Projekteve ka të drejtë të vendosë për një projekt VKM-je apo për një Akt-Marrëveshje institucionale!?

Shprehim bindjen se me bazën ligjore egzistuese dhe me një vullnet e kuptueshmëri të mirë nga ana juaj si kryetar, Akt-Marrëveshja duhet të miratohet, sikurse ju kemi referuar me shëmbuj konkretë aktesh të homologëve tanë Europeanë, në Gjermani, Francë, UK, etj..

Në pritje të një bashkëpunimi ju falenderojmë paraprakisht!

Me respekte

Kujtim Çashku
Drejtor i AFMM-së



AKADEMIA E FILMIT DHE MULTIMEDIAS MARUBI

Kinostudio - Rr. Aleksandër Moisiu nr.78 - Tiranë 1000, Shqipëria
Tel./Fax : +355 42 365 188/157. - info@afmm.edu.al www.afmm.edu.al